

Datë 12/4 /2021 (dymijë e njëzetë e një)

### KONTRATË SHITJE KUOTE

**Shitësi:** **Z. KEREM ISILDAK** shtetas turk, i biri i FAHRI, i datëlindjes 20 Janar 1987, lindur në LEFKOSE, banues në Stamboll / Turqi, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me numër U23829921.  
(në vijim "**Shitësi**")

*Dhe*

**Blerësit:** **Z. YIGIT ARMAN** shtetas shqiptar, i biri i Fahrettin Amir, i datëlindjes 07 Shkurt 1986, lindur në Ankara / Turqi, banues në Adresën Vilat Rolling Hills, Vila 79, Mullet, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit të Republikës së Shqipërisë me numër karte 034301839 dhe numër personal I60207113A.

*Dhe*

**Z. AHMET MIRZALOGLU**, shtetas turk, i biri i YUCEL, i datëlindjes 04 Korrik 1984, lindur në Stamboll / Turqi, banues në Stamboll / Turqi, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me numër U24003679.  
(në vijim "**Blerësi veçmas dhe Blerësit bashkarisht**")

### MEQENËSE:

- A. Z. KEREM ISILDAK është ortak me 20% të kuotave dhe Z. YIGIT ARMAN është ortak me 40% të kuotave dhe Z. AHMET MIRZALOGLU është ortak me 20% të kuotave të kapitalit të shoqërisë tregtare "KAYI" Sh.P.K., një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NUIS M11318030U, me seli në adresën : "Rruga Ibrahim RUGOVA, Nr. 3/99, Tiranë, Shqipëri" (më poshtë referuar "**Shoqëria**").
- B. Shitësi KEREM ISILDAK dëshiron të shesë tek Blerësit YIGIT ARMAN 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kuotave të tij dhe tek Blerësi AHMET MIRZALOGLU 5% (pesë përqind) të kuotave të tij.
- C. Blerësi YIGIT ARMAN pranon të blejë 15% (pesëmbëdhjetë përqind) dhe Blerësi AHMET MIRZALOGLU pranon të blejë 5% (pesë përqind) nga kuotat e Shitësit KEREM ISILDAK.
- D. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me Vendimin bashkëlidhur të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë, Palët dëshirojnë të lidhin këtë Kontrate.

### NË BAZË TË SA MË SIPËR, PALËT RANË DAKORD SI VIJON:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi KEREM ISILDAK i transferon dhe kalon në pronësinë ligjore të Blerësit YIGIT ARMAN 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi YIGIT ARMAN blen 15% (pesëmbëdhjetë përqind) të



kuotave të kapitalit të Shoqërisë, kundrejt çmimit të shitjes prej LEK 15,00 (pesëmbëdhjetë lekë) dhe sipas kushteve e afateve të përcaktuara këtu.

2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi KEREM ISILDAK i transferon dhe kalon në pronësinë ligjore të Blerësit AHMET MIRZALOGLU 5% (pesë përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi AHMET MIRZALOGLU blen 5% (pesë përqind) të kuotave të kapitalit të Shoqërisë, kundrejt çmimit të shitjes prej LEK 5,00 (pesë lekë) dhe sipas kushteve e afateve të përcaktuara këtu.
3. Palët vërtetojnë se pagesa e çmimit të mësipërm të shitjes është kryer tërësisht nga Blerësit në favor të Shitësit me lidhjen e kësaj Kontrate dhe kjo Kontrate shërben edhe si një dëftesë për vërtetimin e pagimit të shumave respektive. Palët e vërtetojnë shlyerjen e çmimit dhe nuk kanë asnjë pretendim tjetër të asnjë lloji.
4. Me lidhjen e kësaj Kontrate Shitësi KEREM ISILDAK rezulton të mos ketë më asnjë përqindje Ortakërie mbi shoqërinë KAYI sh.p.k, Blerësi dhe njëkohësisht Ortaku YIGIT ARMAN rezulton të zotërojë në total 55 % (pesëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë me vlerë totale prej 55,00 (pesëdhjetë e pesë) LEKË dhe Blerësi dhe njëkohësisht Ortaku tjetër AHMET MIRZALOGLU rezulton të zotërojë në total 25 % (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë me vlerë totale prej 25,00 (njëzetë e pesë) LEKË dhe njëkohësisht Blerësve i'u lind e drejta e regjistrimit të pronësisë së tyre mbi kuotat dhe përqindjet në librin e ortakëve dhe në regjistrin tregtar (QKB) sipas ligjit.
5. Shitësi deklaron dhe garanton se 20% e pjesëve të kapitalit të transferuara nëpërmjet kësaj Kontrate, janë në pronësinë e vetme e të plotë ligjore të Shitësit dhe janë të lira nga barra, të drejta të tjera reale apo pengje apo të drejta të çfarëdolloji të palëve të treta mbi to.
6. Blerësit deklarojnë dhe garantojnë se e njohin gjëndjen e Shoqërisë dhe se e kanë verifikuar regjistrimet e saj kontabël si dhe të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë në tërësi dhe për këtë nuk kanë dhe shprehimisht heqin dorë nga çdo rezervë, pretendim apo padi kundër Shitësit.
7. Shitësi dhe Blerësit bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotave objekt të kësaj Kontrate në librin e Ortakëve si dhe në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas kërkesave të ligjit.

Kjo Kontratë u hartua në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga një për secilën Palë.

#### SHITËSI

Z. KEREM ISILDAK

*Kerem ISILDAK*

Përkthyes i Gjuhës Turke

ALTIN KODRA

*Altin Kodra*



#### BLERËSI

Z. YIGIT ARMAN

*Yigit ARMAN*

BLERËSI

Z. AHMET MIRZALOGLU

*Ahmet Mirzaloglu*

*Ahmet Mirzaloglu*